

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – SHERBIME

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

- **Objekti i procedurës:** “Marrja e sistemit ALADIN për parashikimin e motit”.
- **Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (cpv):** 71351610-2 Shërbime meteorologjik.
- **Vlera e fondit limit:** 2,998,600 (dy milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetëmijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor ALBCONTROL SHA ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: *kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: i ndryshuar citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare 2020,2021,2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit të përlogaritur të kontratës.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në llojin e procedurës së prokurimit e cila është: “Procedurë e hapur e thjeshtuar-shërbime”, argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar është një kërkesë e mbështetur në pikën 4 të nenin 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik, duhet të jetë pjesë e konsorciumit ALADIN/ACCORD. Kjo provohet me broshuren dhe logot e shoqërive respektive në këtë konsorcium.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

2.3.3 Operatori ekonomik, duhet të ketë në stafin e tij minimumi 3 eksperte meteorolog, gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të kontratës.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë AK dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

1. CV;
2. Çertifikata;

Argumentim: *Kriteret e mësipërme janë në përputhje me parashikimet e neni 41 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

Njësia e Prokurimit

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Termat e Referencës janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimin objekt procedure prokurimi, natyrën dhe afatin kohor për realizimin e kërtij shërbimi si dhe bazuar në nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 41/1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Shënim: Përcaktimi i specifikimeve teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet Teknike për marrjen e te dhenave te motit nga modeli numerik ALADIN

PËRMBAJTJA

<u>HYRJE</u>	3
<u>KONFIDENCIALITETI</u>	4
<u>1. TË PËRGJITHËSHME</u>	5
<u>1.1 GAMA E FURNIZIMIT</u>	5
<u>2. KËRKESAT TEKNIKE PËR SHERBIMIN E KERKUAR</u>	6
<u>3. KERKESA PER KAPACITETIN TEKNIK TE SISTEMIT</u>	6

Hyrje

Albcontrol është angazhuar për të përmbushur standartet e kerkuara nga OBM dhe ICAO në ofrimin e shërbimit meteorologjik të aviacionit.

Analizimi disavjekar i problemetikave dhe evidentimi i domosdoshmerise se nje infrastructure meteorologjike te besueshme, te testuar dhe up to date si dhe vleresimi i perfitimeve nga perdorimi i burimeve te licensuara te te dhenave meteorologjike per zonen tone te pergjegjesise konkluduan te meposhtmet:

- Shërbimi që kërkohej të prokuronte përmirëson cilësinë e produkteve që Drejtoria MET ofron duke rritur saktësinë e parashikimit.
- Promovon konsistencë të këtij shërbimi si në zonën e aerodromit po ashtu edhe në FIR-in shqiptar.
- Rrit kompetencën e stafit në përpunimin e të dhënave për përmbushjen e detyrave operacionale
- Ndihmon në përmbushjen e objektivave operacionale të organizatës
- Rrit sigurinë dhe efikasitetin e fluturimeve duke u fokusuar në zonën e përgjegjësisë së ofrimit të shërbimeve meteorologjike nga Albcontrol që mbulon shërbimet meteorologjike për operimet në aerodrom, operimet në zonën e terminalit dhe operimet në mbikalimet ajrore.

Konfidencialiteti

I gjithë Informacioni i marrë nëpërmjet kësaj procedure është pronë e Albcontrol dhe ofertuesit nuk mund ta përdorin apo shpërndajnë tek të tretë përveçse për nevojat e përmbushjes dhe plotësimit të ofertës së tyre.

Po kështu oferta e dorëzuar në Albcontrol do të trajtohet si konfidenciale dhe nuk do të shpërndahet tek të tretë jashtë Albcontrol-it.

1. Të Përgjithëshme

Për përcaktimin e specifikimeve teknike u ngarkua Struktura e Posaçme sipas Urdhërit të Brendshëm Nr. 349/1, datë 02.02.2024, për objektin e prokurimit: “Marrja e sistemit ALADIN për parashikimin e motit”.

Subjekti i këtij tenderi është blerja e produkteve numerike të parashikimit të motit për përdorim në ALBCONTROL për vitin 2024-25. Produktet e kërkuara përfshijnë parashikimet për të paktën tre ditë (72 orë) më parë, të cilat do të përdoren për të menaxhuar dhe optimizuar aktivitetet që lidhen me kontrollin e trafikut ajror.

Parashikimet e kërkuara përfshijnë disa variabla 2D ose 3D në lartësi të ndryshme në të gjithë atmosferën. Ato do të bëhen të disponueshme në formatet GRIB, ASCII dhe grafike. Zona që do të mbulohet me parashikime është Republika e Shqipërisë. Për shkak të kompleksitetit të pronave gjeofizike shqiptare hapësira maksimale horizontale e rrjetit të modeleve bazë duhet të jetë 2 km për eren dhe 4 km për fusha të tjera. Parashikimet duhet të rifreskohen të paktën katër herë në ditë duke përdorur të dhënat e vëzhguara nga Evropa Juglindore për të siguruar të dhëna të përditësuara dhe të besueshme të parashikimit. Një përshkrim i hollësishëm është dhënë në specifikimet teknike i cili është pjesë e këtij dokumenti.

Periodha e shërbimit është 12 muaj pas nënshkrimit të kontratës.

1.1 Gama e Furnizimit

Ofertuesit do të ofrojnë shërbimet si vijon:

- 1- Parametrat specifik të parashikimit sipas tabelës së kërkesave teknike
- 2- Të dhënat e motit të specifikuar në perputhje me zonën e përgjegjësisë së Albcontrol
- 3- Gama e parashikimit duhet të jetë së paku 72 orë përpara
- 4- Frekuenca e parashikimit të modelit NWP të rifreskuar do të jetë katër herë në ditë
- 5- Hapësira e rrjetës horizontale duhet të jetë të paktën 2 km për shpejtësinë dhe drejtimin e erës 10 metra dhe të paktën 4 km për variabla të tjera të modelit.
- 6- 24 ore suport teknik për çdo problem në lidhje me ofrimin e produktit

2. Kërkesat teknike për shërbimin e kërkuar

1. Kërkesat teknike për shërbimin e kërkuar	
Nr i specifikimit	Specifikimi
G-2.1	Suporti teknik do të jetë 24/7 (help desk) për këtë suport kontraktuesi do të vejë në dispozicion të Albcontrol

	numrat e telefonit te sherbimit.
G-2.2	Adaptimi i komponimeve u dhe v të erës ne 10m dhe dinamika
G-2.3	<p>Parametrat e meposhtem do të shfaqen në variablat 3D në nivelet:</p> <p>1- komponenti u dhe v era 2- temperatura 3- Lartësia gjeopotenciale 4- lageshtia relative 5- temperatura ekuivalente 6- shpejtësia vertikale e erës 7- vorticiteti</p> <p>1000, 996, 985, 975, 970, 950, 925, 900, 875, 850, 825, 800, 760, 730, 700, 660, 630, 600, 550, 500, 450, 400, 350, 300, 250, 200, 150, 130, and 100 hpa.</p>
G-2.4	<p>Variablat 2D</p> <p>u dhe v përbërësi i erës dhe fryrjes së erës në 10m; Presion MSL; Lagështia relative ne 2m; Temperaturën ne 2m; vranësira totale, konvektive, e lartë, e mesme dhe e ulët; energji potenciale konvektive në dispozicion (CAPE); indeksi i ngritur (LI); reshjet (të lëngshme dhe të ngurta) veçmas për retë konvektive dhe stratiforme</p>
G-2.5	RAW Data ne te gjithë nivelet per te furnizuar sistemin IBL, qe të jetë në gjendje të vizualizojë modelet numerike, hartat, pseudotemps, përbërës të ndryshëm, për analizimin, diagnostikimin dhe parashikimin e motit.
2. Kërkesa per kapacitetin teknik te sistemit	
Nr i Specifikimit	Specifikimi
T-3.1	Gama e parashikimit duhet të jetë së paku 72 orë përpara.
T-3.2	Frekuenca e parashikimit të modelit NWP të rifreskuar do të jetë katër herë në ditë.
T-3.3	Hapësira e rrjetës horizontale duhet të jetë të paktën 2 km për shpejtësinë dhe drejtimin e erës 10 metra dhe të paktën 4 km për variabla të tjera të modelit
T-3.4	Formati i outputit do të jetë i disponueshëm në GRIB, grafike dhe ASCII
T-3.5	Matjet në Shqipëri dhe në vendet fqinje te jenë asimiluar në produktin e parashikuar Të paktën 70 shtresa në atmosferë për 3D të kërkuara.
T-3.6	Verifikimi i modelit duhet të jetë i disponueshëm në baza mujore për muajin paraprak për matje
T-3.7	Arkivi i parashikimit të tij duhet të jetë i disponueshëm për të paktën një vit paraprak
T-3.8	Shërbimi i kërkuar do të jetë i disponueshëm nëpërmjet aplikimit bazë

	të internetit
T-3.9	Infrastruktura HW do të jetë në pronësi dhe objekt mirëmbajtje e furnizuesit duke siguruar që kërkesat minimale të renditura më poshtë janë përmbushur: 1- OS - Linux 2- Minimum 4 servera (Processin, Post processing, FTP dhe arkiv) 3- RAM - 100 GB ose më e madhe 4- Server FTP - RAM 100 GB, Procesor: 2x Intel Xeon E7
T-3.10	24h suport teknik për çdo problem teknik ne lidhje me ofrimin e produktit